



# KËSHILLA PRAKTIKE

për prindërit me fëmijë,  
me vështirësi në të nxënë  
dhe aftësi të kufizuara



Save the Children



## INFORMACION PËR PRINDËRIT

Publikimi që keni në duar, i'u vjen në ndihmë prindërve të fëmijëve që paraqesin vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara, gjatë procesit të gjatë dhe të vështirë të rritjes, përkujdesjes, edukimit dhe socializimit të tyre.

## **Mirënjohe**

Falenderojmë organizatën “Save the Children, Programi për Shqipërinë dhe në mënyrë të veçantë z. Refik Çela dhe Znj Rodika Goci, të cilët kanë mbështetur inisiativën për hartimin dhe publikimin e kësaj broshure.

© E drejta e botimit, ribotimit shumëfishimit të këtij materiali është vetëm e Shoqatës “MEDPAK” dhe organizatës “Save the Children”.

Përgatiti materialet: Marina NDRIO

Formulimi grafik: Artemida Hinaj

Formulimi grafik i kopertinës: Artemida Hinaj

**Financuar nga “Save the children”, Programi për Shqipërinë**

**Botuar, Shqipëri, 2010**



# KËSHILLA PRAKTIKE

## KËSHILLA PRAKTIKA PËR PRINDËRIT ME FËMIJË, QË PARAQESIN VËSHITËRËSI NË TË NXËNË DHE AFTËSI TË KUFIZUARA.

Hapi i parë dhe më i rëndësishmi që një prind mund të bëjë për fëmijën e tij me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë, është të besojë në aftësitë e tij, të cilat janë të shumta.

Janë prindërit aktorët e parë që duhet të realizojnë integrimin e fëmijë së tyre brenda ambjentit familjar dhe jashtë tij.

Por ky integrim duhet bërë me shumë kujdes, sepse prindërit nuk duhet të kalojnë në pozita supermbrojtëse, për fëmijën e tyre. Prindërit nuk duhet të lejojnë që fëmija të ndihet i “mbimbrotur”, por t’u trajtojnë si të gjithë fëmijët e tjerë, duke e disiplinuar dhe duke e bërë të ndihet i respektuar dhe i përgjegjshëm brenda mundësive të tij .

Ky duhet të jetë një objektiv i vërtetë i të gjithë prindërve, që në të ardhmen, fëmijët e tyre të mirëpritën dhe tolerohen nga bashkëmoshatarët dhe antarët e tjerë të komunitetit ku ata jetojnë, duke u konsideruar si gjithë të tjerët

Prindërit duhet të pranojnë se: Të vlerësosh një arritje ka më shumë dobi sesa të vësh në dukje një mangësi, apo kufizim të fëmijës me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara, në çdo aspekt të jetës së tij.

Ata duhet të vlerësojnë çdo përpjekje të fëmijës. edhe atëherë kur ai nuk arrin rezultatin e pritshëm, sidoqoftë ka bërë diçka, qoftë edhe përpjekja më e vogël duhet të vlerësohet me një vlerësim, të cilin fëmija duhet t’u ndjejë, t’u shohë, t’u kuptojë.

## Fëmija me aftësi të kufizuara, pjesë e rëndësishme e kontekstit familjar dhe përgjegjësitë prindërore

- Prindërit duhet të marrin përgjegjësitë e tyre lidhur me rritjen, socializimin, arsimimin dhe integrimin e gjithëpërfshirjen e fëmijës së tyre.
- Ata duhet të përpiqen dhe të ndihmojnë në procesin e edukimit, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të fqinjëve, të afërmëve, motrave dhe vëllezërve, edukatoreve, mësueseve, prindërve të tjerë, si dhe komunitetit ku jetojnë, për zgjidhjen e problemeve të fëmijës së tyre.
- Ata duhet të marrin masat e duhura dhe të kërkojnë mbështetje dhe përkrahje nga strukturat përkatëse, që fëmija i tyre të rregjistrohet në kopshtin apo shkollën e duhur.
- Gjithashtu, ata duhet të ndihmojnë dhe mbështesin fëmijën, duke zbatuar planet dhe programet e punës, duke vlerësuar dhe konsideruar jo vetëm nevojat, por edhe dëshirat dhe interesat e tyre.
- Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuara kërkon mundin, dashurinë dhe përkushtimin e të dy prindërve

Prindërit duhet të përgatisin integrimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijës së tyre me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë, pikësëpari brenda ambjentit familjar, duke ndërgjegjësuar fëmijët e tjerë për nevojat dhe trajtimin e tij.

Prindërit që rrisin një fëmijë, i cili paraqet vështirësi në të nxënë ose ndonjë tip aftësie të kufizuar duhet të respektojnë dhe konsiderojnë njësojë edhe fëmijët e tjerë, të familjes. Ata duhet të përpiqen të kuptojnë çdo dëshirë të tyre, të jenë të kujdesshëm për t'ju krijuar atyre një ambjent të ngrohtë dhe të këndshëm familjar. Ambjenti i familjes duhet të përgatitet për rritjen e fëmijës me nevoja të veçanta, Fëmijët e tjerë duhet të jenë të qartë se vëllai apo motra e tyre kanë nevoja specifike që kërkojnë më shumë përkushtim dhe vëmendje nga prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.



## Sugjerime për prindërit që kanë fëmijë me vështirësi në të nxënë apo dhe me aftësi të kufizuara.

- Shikojeni fëmijën tuaj si të papërseritshëm dhe të kompletuar, si një qenie të plotë, që nuk ka nevojë të krahasohet me të tjerët. Është fëmija juaj dhe ju jeni personat e parë që duhet t'a pranoni ashtu siç ai është, me të gjitha problemet, vështirësitë, kufizimet që ka.

- Kur ai ose ajo bën një gabim, përpiquni të kritikoni vetëm sjelljen e atij momenti dhe jo pjesë të karakterit, personalitetit apo zhvillimit të tij intelektual dhe kufizimeve që ai mund të ketë.

- Fëmija juaj, qoftë djalë apo vajzë ka nevojë edhe të disiplinohet, t'i mësohet se ç'është e mira dhe e keqja, por duhet pasur kujdes, disiplinim nuk do të thotë ndëshkim.

- Këta fëmijë nuk duhet të përkëdhelen në mënyrë të tepruar. Ata duhen trajtuar njësoj sikurse ju trajtoni dhe fëmijët e tjerë në familje.



- Krijojini mundësi fëmijëve tuaj që të eksplorojnë botën e tyre, hapeni shtëpinë për shokët dhe shoqet e fëmijëve tuaj, pavarësisht faktit nëse janë fëmijë me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë.

- Krijoni hapsira që edhe ata të krijojnë shoqërinë e tyre brenda mundësive që ata kanë.

- Dilni shpesh me ta në natyrë dhe tregojini vazhdimisht se i doni shumë, se jeni me ta dhe se nuk ndjeheni keq në praninë e tyre.

- Këndoni e luani bashkë me ta.

- Shfaqni interes për atë çka ata bëjnë ose dëshirojnë të bëjnë.

- Mos i nënvleftësoni kurrë ata, por përpiquni të respektoni personalitetin e tyre.

- Flitini vazhdimisht e për çdo gjë, madje edhe atëherë kur duket se nuk ju dëgjojnë apo kuptojnë, flitini për njerëzit që keni pranë, për sendet, fenomenet e ndryshme etj si këto.

- Jepini kohë fëmijëve tuaj t’ju tregojnë përmes mënyrave të ndryshme atë ç’ka kanë bërë dhe pse mund të kenë vështirësi për t’ju treguar apo për t’u shprehur.

- Shfrytëzoni momentet kur ata janë të qetë, ndihmojini për të kryer proceset e vetsherbimit, tregohuni të dashur e pergedhelës me ta vazhdimisht, pavarësisht ngarkesave dhe problemeve tuaja të jetës së përditshme.

- Kthehuni gjithmonë nga fëmija juaj dhe shikojini në sy sa herë ju flet apo i flisni.

- Kur flisni me ta përdorni fjalë të thjeshta, mos tregoni se nuk keni kohë t’u sqaroni apo shpjegoni këtë apo atë fenomen apo ndodhi.



- Nëse fëmija juaj përpiket të mësojë diçka nga ju, duhet t'a drejtoni, edhe pse nuk do të jetë ne gjëndje t'a bëjë atë, lëroni të përpiket dhe ndërhyri në momentin e duhur.

- Ata kanë nevojë për vëmendjen, dashurinë dhe mbështetjen tuaj.

- Krijoni mundësira që ata të marrin pjesë në bisedat familjare edhe pse ndonjëherë mund të duket e pamundur pjesmarrja e tyre.

- Ndërprisni çdo aktivitet kur ai ose ajo ju flet, apo ju kërkon ndihmë per diçka.

- Ndihmojini kur ata kanë vështirësi për të treguar apo përshkruar diçka.

- Kurrë mos i kërkon:”përsërite”, “fol mirë”, “ec mirë”, “mos e prek” etj si këto.

- Lëroni ata të kryejnë sa më shumë veprime, që të jetë e mundur, sidomos veprimet e nevojshme për veten.

- Mos harroni: Fëmija juaj mëson shumë nga sjelljet, qëndrimet dhe mënyrat tuaja të komunikimit, .

- Nxitini sa më shumë të mundni përpjekjet e tyre për pavarësi dhe autonomi personale.

- Mos u shprehni kurrë se jeni të lodhur nga ai ose ajo, mos harroni se askush nuk ka dëshirë të fyhet pavarësisht nga mosha dhe problemi që ka.

- Kur reagoni ndaj sjelljeve apo problemeve që ata shfaqin, mos harroni moshen e tyre, aftesinë e kufizuar, apo vështirësinë në të nxënë që ata kanë.

- Mësojini ata me shembullin tuaj që të kenë besim në mundësitë dhe kapacitetet e tyre.

- Mos kërkon gjëra të pamundura nga ata, duhet të mesoheni të toleroni sjelljet dhe qëndrimet e tyre, që vijnë nga vështirësitë që ata kanë.

- Pranoni realitetin dhe bëni përpjekje për t'a ndryshuar atë brenda hapsirave të mundshme.

- Lavdërojeni përqafojeni, dhe jepini një shpërblim kur ai ose ajo bën diçka të mirë.

- Mendoni që të gjeni rrugët dhe mënyrat për të ndihmuar fëmijën tuaj në mënyrë, që të shfrytëzohen në maksimum potencialet dhe kapacitetet e tij.

- Përpiquni t'i kuptoni mundësitë dhe aftësitë e tyre.

- Ata shpesh kanë nevojë që ju t'i konsideroni ata si “fëmijë normalë, të zakonshëm, si gjithë të tjerët.”

- Mënyra sesi ju luani, mësoni, flisni, silleni me ta, ka më shumë rëndësi sesa koha që kaloni me ta.

## **PRINDËRIT DHE MËSUESIT, PARTNERË DHE BASHKËPUNTORË TË NGUSHTË PËR TË MBËSHTETUR PROCESIN E ARSIMIMIT DHE SOCIALIZIMIT TË FËMIJËVE ME VËSHITRËSI NË TË NXËNË, APO ME AFTËSI TË KUFIZUARA.**

### **Përfshirja e fëmijës me aftësi të kufizuara në shkollë dhe bashkëpunimi efektiv ndërmjet prindërve dhe mësuesve do të ndihmojnë në:**

- Krijimin e një kulture drejt tolerancës, pranimit, hapjes, respektit ndaj të ndryshmes, të veçantës,

- Krijimin e besimit dhe sigurisë tek prindërit se nuk janë të vetëm në rrugën e gjatë dhe të vështirë të rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre.

- Të kuptuarin e nocionit se” Normaliteti është mundësia për të jetuar pa ndjenjen e frikes, fajit, turpfit, ankthit, stresit, është aftësia për të pranuar, toleruar dhe mbështetur ata që kanë nevojë, është shans për

të dashur dhe për t'u dashur nga të tjeret, është pjesë e të përditshmes me të mirat dhe të këqijat e saj.

Prindërit dhe mësuesit duhet të jenë në partneritet me njëri - tjetrin për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijën me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë gjatë procesit të rritjes, edukimit dhe socializimit të tij



Prindërit kanë nevojë të udhëhiqen për të kuptuar, për të planifikuar dhe për të ndihmuar zhvillimin e fëmijës së tyre nëpërmjet këshillimit, mësimit dhe dëgjimit të kujdesshëm . Ata kanë nevojë të mësojnë teknika mësimore për të luajtur, kujdesur dhe ndihmuar fëmijët e tyre.

Megjithëse prindërit dhe mësuesit kanë të njëjtin qëllim të përbashkët: të ndihmojnë fëmijën për t'u përshtatur sa më mirë me mjedisin, si dhe të aftësojnë atë për të mësuar dhe përvetësuar elementët e proceseve edukative dhe socializuese, shpesh ata përdorin teknika dhe mënyra të ndryshme për realizimin e këtyre qëllimeve. Këto teknika dhe metoda edhe pse mund të jenë të ndryshme, duhet të jenë në harmoni dhe të plotësojnë njëra – tjetrën.

Prindërit dhe mësuesit shpesh shfaqin diferenca në rolet e tyre sociale përkundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.

Në familje, ndryshe nga institucioni arsimor fëmija mund të ndjehet i lirë të plotësojë nevojat e tij të ndryshme. Gjithashtu, vlen të theksohet se në familje fëmija kalon një kohë relativisht më të gjatë sesa në kopësht apo shkollë. Fakti që prindërit kanë më shumë kohë për të qëndruar me fëmijët e tyre ndryshe nga mësuesit që e kanë të kufizuar kohën e qëndrimit me fëmijët, tregon se jo gjithmonë çdo dëshirë apo nevojë e fëmijës mund dhe duhet të plotësohet nga edukatorët, mësueset. Shpesh

mësuesit i kushtojnë rëndësi elementëve të procesit mësimor për fëmijën dhe jo aspekteve të tjera të përkujdesjes ndaj tij

## ROLET SOCIALE TË PRINDËRVE DHE MËSUESVE

Prindërit janë pranë fëmijëve të tyre me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë për t'i i ndihmuar ata të përshtaten me ambjentin familjar, me stilin e tyre të jetës. Prindërit janë të aftë t'a bëjnë këtë, duke u ndihmuar nga eksperiencia dhe përvoja e tyre, si dhe nga fakti që ata njohin nevojat e ineresat e veçanta të fëmijës së tyre. Shpesh, kjo përvojë dhe eksperiencë nuk konsiderohet apo nuk merret parasysh nga edukatorët dhe mësueset, kur fëmija shkon në kopësht apo në shkollë Nisur nga rolet dhe detyrat e edukatoreve dhe mësueseve, ata duhet t'u përcjellin fëmijëve me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë një numër dijesh, si në aspektin shkollor, ashtu edhe në atë social;

Përmbushja e këtyre roleve dhe detyrave nuk mund të realizohet nëse prindërit dhe mësuesit nuk kordinojnë përpjekjet e tyre, nëse nuk gjejnë pika të përbashkëta dhe nëse nuk plotësojnë punën e njëri – tjetrit.

Prindërit duhet të ndjehen të qetë se fëmijët e tyre në kopshte apo shkolla janë në duar të sigurta, janë në vendin e duhur dhe në kohën e duhur. Prindërit dhe mësuesit duhet të ndajnë çdo hap, proces, detyrë, përgjegjësi rezultat midis tyre, në çdo fazë të ndëhyrjes apo punës me fëmijët me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë.



## PRINDËR!

Dëgjoni mendjehapur kur mësuesja apo personeli i shkollës ju shpreh shqetësime për përparimin dhe zhvillimin e fëmijës tuaj.

Mohimi dhe refuzimi nuk e ndihmon fëmijën,  
**BASHKEPUNIMI PO!**



Shoqata "MEDPAK" në bashkëpunim me Save the Children, Programi për Shqipërinë, Ministrinë e Arsimit, Drejtoritë Rajonale të qyteteve Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë përmes projektit Arsimi gjithëpërfshirës - Kërkesë e Mijëvjeçarit të Ri – 2010" po mbështet procesin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e arsimit bazë. Në sajë të kësaj mbështetje, një numër i konsiderueshëm fëmijësh me aftësi të kufizuara përfitojnë nga një arsimim më cilësor dhe në përshtatje me veçoritë e tyre individuale. Puna për zbatimin e projektit është përqëndruar në këto drejtime:

1. Në aplikimin dhe përhapjen e praktikave mësimore më të përshtatshme, lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në kopshtet dhe shkollat e këtyre qyteteve, duke synuar një shkollë për të gjithë fëmijët.

2. Në përgatitjen e edukatoreve, mësuesëve dhe punonjësve të shërbimit Për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.

3. Në krijimin e një atmosfere mikpritëse dhe mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga bashkëmoshatarët, mësuesit, psikologët, prindërit e fëmijëve të tjerë.

Pjesë e rëndësishme e këtij projekti janë edhe materialet e shumta informative që publikohen në vazhdimësi dhe që ju vijnë në ndihmë mësuesëve, prindërve, komunitetit..

Për të mësuar më shumë rreth këtij projekti ose dhe për të pasur në duar materialet e publikuara deri tani, ju lutem na kontaktoni në këtë adresë:

MEDPAK

Adresa: Rruga "Sh. Ishmi" Pallati 38 Shkalla 1 Apt 2 Tirane

Tel: + 355 4 22 345 028/+ 355 69 22 08 985/

+ 355 68 25 78 002

E-mail: info@medpak.org/ www.medpak.org



**Save the Children**

